



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 129/13
Prishtinë, më 14.10.2013, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan : Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Duda Balje dhe Sevdije Lama.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Avdiu zv.ministër i financave, Jeton Oruçi ga Zyra e Kryeministrit, Enis Spahiu nga Ministria e Financave, Ilir Krasniqi-Standardi, Flutura Gashi-Rrokum TV, Liridona Xhemajli – RTV21, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 04.10.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L196 për Fshatim Zymi i Hasit me amendamentet e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, dt. 04.10.2013

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja sa i përket projektligjit nga sponsorizuesi thuhet që nuk ka implikime buxhetore, ndërkaq sa i përket amendamenteve të komisionit funksional nuk shihet që ka implikime buxhetore. Ne sot e kemi të pranishëm zëvendës Ministrin e Financave që të na jep një informatë pak më të detalizuar, sepse kemi një deklaratë nga Ministria e Financave që ky projektligj mund të prodhojë kosto buxhetore por nuk ka ndonjë shumë dhe vlerë të përcaktuar.

Ramadan Avdiu ndonëse sponsorizuesi i ligjit - zyra e kryeministrit në deklaratën e sajë nuk ka paraparë kosto shtesë buxhetore, në Ministrinë e Financave e shohim se mund të ketë një kosto të vogël për shkak që parashihet krijimi i një bordi për licencimin profesional, krijimi i një regjistri qendror, por nuk kemi këtu shpenzime shumë të mëdha. Ne mundë të dalim specifikisht sepse në ligj në nenin 10 parashihet edhe krijimi i disa bordeve tjera për licencimin specifike. Çdo implikim buxhetor do të absorbohet nga inventarët buxhetore që ka zyra e kryeministrit në këtë rast.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni me pesë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi) një kundër (Hykmete Bajrami) dhe një abstenim (Xhevdet Neziraj) nxorri këtë

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe amendamentet e Komisionit Funkcional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L196 për Fshatim Zymi i Hasit me amendamentet e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja nga deklarata financiare e sponsorizuesit që në këtë rast është Kuvendi shifet që ky projektligj ka kosto buxhetore për vitin 2014 prej 40,000 euro, Ministria e Financave në njëfarë mënyre e ka mbështetur këtë si kosto të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Hykmete Bajrami në parim nuk jam kundër ligjit, vetëm se ne kur aprovojmë ligje të tilla, Ministria e Financave veçanërisht duhet të ketë parasysh se puna nuk përfundon me kaq. Ne kemi me pas tash shumë kërkesa për të miratuar ligje edhe për fshatrat tjera, sepse Zymi i Hasit nuk dallon prej fshatrave të Kosovës kemi me pas plotë fshatra të tjera që kanë karakteristika të njejta ose më të veçanta se ky fshat, dhe ka me pas kërkesa dhe presion në Kuvend që të miratohen ligje të veçanta.

Kryetarja ju e dini që në këtë rast nuk është sponsorizues Qeveria, është sponsorizues një grup parlamentar. Ligji ka kaluar në Kuvend në lexim të parë, komision funksional nuk ka bërë ndonjë amendament që ndryshon esencën e ligjit. Kosto buxhetore është 40,000 euro Qeveria nuk e ka refuzuar me këtë kosto buxhetore, nuk është ndonjë kosto e papërballueshme.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligjit nr.04/L196 për Fshatim Zymi i Hasit me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk përmban implikime buxhetore shtesë

5. Të ndryshme

Naser Osmani lidhur me monitorimin e ligjit mbi lojërat e fatit, ne gati jemi tani në fazën përfundimtare kemi bërë hulumtimet e nevojshme në dogana në administratën tatimore kemi marrë si mostër tri komuna Prishtinën, Ferizajin dhe Prizrenin fjala është aty ku është shkelë ligji që nuk janë respektuar normat kriteret ku lojërat e fatit janë afër institucioneve publike dhe afër shkollave. Në ditën e Mërkurë komisioni ka caktuar takim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe besojë se shumë shpejt do të përfundojmë punët.

Latif Gashi edhe ne si grup punues e kemi përfunduar punën tonë dhe besojë që së shpejti do ta keni edhe raportin përfundimtar.

Mbledhja përfundoi: 10:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj